

RREGULLORE E
LOJËS SË FATIT PROMOCIONALE ME TITULL:
“PËRDITËSO TË DHËNAT PERSONALE”

Autorizuar nga Ministria e Fiancave me autorizimin nr. 4156/1, dt. 31/08/2018, Banka Credins Sh. A. vjen me një lojë që synon nxitjen e përditësimit të të dhënave të klientëve e saj.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, pika 5, e 70, pika 5, të ligjit nr.155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”

Neni 1

ORGANIZATORI I LOJES PROMOCIONALE

Shoqëria aksionere “BANKA CREDINS” Sh.a., me adresë Rr.“Vaso Pasha”, Nr. 8, një shoqëri e krijuar që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, Nr.28969, Dt.31.01.2003, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NIPT K316088010 si dhe me licencën Nr.16, Dt.31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, që ligjërisht përfaqësohet nga zv. Drejtore e Përgjithshme, Znj. Monika Milo, referuar ketu me poshte si “Credins”. Banka Credins Sh.A është i regjistruar si subjekt tatimpagues ne Drejtorine Rajonale Tatimore te Tatimpaguesve te Medhenj, Tirane.

Me anë të kesaj Loje Promocionale, Credins ka për qëllim të nxisë klientët që të përditësojnë të dhënat e tyre në bankë.

Neni 2

AFATI

Loja Promocionale do të zhvillohet në një periudhë kohore prej 12 muajsh. Loja promocionale do të fillojë në datë 1.09.2018 dhe do të përfundojë në datën 31.08.2019. Loja promocionale do të ndahet ne 12 (dymbëdhjetë) periudha kohore si më poshtë vijon:

1. Periudha e parë prej datës 01.09.2018 deri në datën 30.09.2018
2. Periudha e dytë prej datës 01.10.2018 deri në datën 31.10.2018
3. Periudha e tretë prej datës 01.11.2018 deri në datën 30.11.2018
4. Periudha e katërt prej datës 01.12.2018 deri në datën 31.12.2018

5. Periudha e pestë prej datës 01.01.2019 deri në datën 31.01.2019
6. Periudha e gjashtë prej datës 01.02.2019 deri në datën 28.02.2019
7. Periudha e shtatë prej datës 01.03. 2019 deri në datën 31.03.2019
8. Periudha e tetë prej datës 01.04. 2019 deri në datën 30.04.2019
9. Periudha e nëntë prej datës 01.05.2019 deri në datën 31.05.2019
10. Periudha e dhjetë prej datës 01.06.2019 deri në datën 30.06.2019
11. Periudha e njëmbëdhjetë prej datës 01.07.2019 deri në datën 31.07.2019
12. Periudha e dymbëdhjetë prej datës 01.08.2019 deri në datën 31.08.2019

Me anë të kësaj Loje, Credins ka për qëllim të nxisë:

- Përditësimin e të dhënave të klienteve në bank
- Të përmirësojë komunikimin me klientet falë përmirësimit të të dhënave
- Të jetë në përputhje me rregullorën e rë të Bankës së Shqipërisë për transparencën që parashikon njoftimin në kohë të klientëve përmes të gjitha kanaleve të komunikimit për ndryshimet që ndodhin në kushtet dhe tarifat e bankës

Nëpërmjet kësaj loje fati promovionale Banka Credins sh.a do të shperblejë klientët fitues me çmimet e përcaktuara në nenin 6 të kësaj rregullore.

Neni 3

PJESËMARRJA

Pjesëmarrës në këtë Lojë Fati Promocionale kanë të drejtë të jenë:

Të gjithë klientët të cilët paraqiten në degën e bankës dhe plotësojnë formularin e përditësimit të të dhënave.

Nuk mund të marrin pjesë në këtë Lojë Fati Promocionale punonjësit e Banka Credins sh.a.

Neni 4

TERRITORI

4.1 Loja promovionale do të zhvillohet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Plotësimi i formularit mund të bëhet në çdo degë të Banka Credins sh.a në gjithë Shqipërinë.

Neni 5

MEKANIZMI I LOJËS PROMOCIONALE

Çdo klient i cili paraqitet në një nga degët e bankës dhe plotëson formularin e përditësimit të të dhënave bëhet automatikisht pjesë në këtë lojë promovionale.

Hedhja e secilit shorte dhe shpallja e klientëve fitues do të bëhet pranë zyrave qendrore të Banka Credins me vendndodhje në Rruga Vaso Pasha, nr.8, Tiranë, Shqipëri, ditën përcaktuar në nenin 5 që i korrespondon secilës periudhë të shorteut. Ora e shorteut do të jetë 12:00 dhe do të publikohet në faqen zyrtare në internet www.bankacredins.com.

Hedhja e shorteut për lojën promovionale do të bëhet dymbëdhjetë herë në varësi të periudhës kohore të lojës së fatit promovionale. Konkretisht:

Shorteu i parë*:

Periudha e parë prej datës 01.09.2018 deri më datën 30.09.2018 do të hidhet me datë 04.10.2018, ditë e Enjte. Në këtë shorte përfshihen të gjithë ata klientë që kanë përditësuar të dhënat e tyre duke filluar nga data 01.09.2018.

Shorteu i dytë:

Periudha e dytë prej datës 01.10.2018 deri me datën 31.10.2018 do të hidhet me datë 06.11.2018, ditë e Martë. Në këtë shorte përfshihen të gjithë ata klientë që kanë përditësuar të dhënat e tyre duke filluar nga data 01.09.2018.

Shorteu i tretë:

Periudha e tretë prej datës 01.11.2018 deri me datën 30.11.2018 do të hidhet me datë 06.12.2018, ditë e Enjte. Në këtë shorte përfshihen të gjithë ata klientë që kanë përditësuar të dhënat e tyre brenda periudhës së sipercituar.

Shorteu i katërt:

Periudha e katërt prej datës 01.12.2018 deri më datën 31.12.2018 do të hidhet me datë 09.01.2019, ditë e Mërkurë. Në këtë shorte përfshihen të gjithë ata klientë që kanë përditësuar të dhënat e tyre brenda periudhës së sipercituar.

Shorteu i pestë:

Periudha e pestë prej datës 01.01.2019 deri me datën 31.01.2019 do të hidhet me datë 07.02.2019, ditë e Enjte. Në këtë shorte përfshihen të gjithë ata klientë që kanë përditësuar të dhënat e tyre brenda periudhës së sipercituar.

Shorteu i gjashtë:

Periudha e gjashtë prej datës 01.02.2019 deri më datën 28.02.2019 do të hidhet me datë 06.03.2019, ditë e Mërkurë. Në këtë shorte perfshihen të gjithë ata klientë që kanë përditësuar të dhënat e tyre brenda periudhës së sipercituar.

Shorteu i shtatë:

Periudha e shtatë prej datës 01.03. 2019 deri më datën 31.03.2019 do të hidhet më datë 04.04.2019, ditë e Enjte. Në këtë shorte perfshihen të gjithë ata klientë që kanë përditësuar të dhënat e tyre brenda periudhës së sipercituar.

Shorteu i tetë:

Periudha e tetë prej datës 01.04. 2019 deri më datën 30.04.2019 do te hidhet më datë 06.05.2019, ditë e Hënë. Në këtë shorte perfshihen të gjithë ata klientë që kanë përditësuar të dhënat e tyre brenda periudhës së sipercituar.

Shorteu i nëntë:

Periudha e nëntë prej datës 01.05.2019 deri më datën 31.05.2019 do të hidhet më datë 06.06.2019, ditë e Enjte. Në këtë shorte perfshihen të gjithë ata klientë që kanë përditësuar të dhënat e tyre brenda periudhës së sipercituar.

Shorteu i dhjetë:

Periudha e dhjetë prej datës 01.06.2019 deri më datën 30.06.2019 do të hidhet më datë 04.07.2019, ditë e Enjte. Në këtë shorte perfshihen të gjithë ata klientë që kanë përditësuar të dhënat e tyre brenda periudhës së sipercituar.

Shorteu i njëmbëdhjetë:

Periudha e njëmbëdhjetë prej datës 01.07.2019 deri më datën 31.07.2019 do të hidhet më datë 07.08.2019, ditë e Mërkurë. Në këtë shorte perfshihen të gjithë ata klientë që kanë përditësuar të dhënat e tyre brenda periudhës së sipercituar.

Shorteu i dymbëdhjetë:

Periudha e dymbëdhjetë prej datës 01.08.2019 deri në datën 31.08.2019 do të hidhet më datë 05.09.2019, ditë e Enjte. Në këtë shorte perfshihen të gjithë ata klientë që kanë përditësuar të dhënat e tyre brenda periudhës së sipercituar.

Në çdo sesion që do te hidhet shorteu, shpallja e klientëve fitues do të bazohet në një përzgjedhje rastërore, nëpërmjet sistemit, i cili përzgjedh automatikisht dhe në mënyrë rastërore 5 emra klientesh qe shpallen fitues. Pjesa tjetër e emrave te klienteve në këtë listë do të shërbejnë si listë rezervë në rast se fituesi i sesionit nuk do të pranojë apo nuk do të kualifikohet për tërheqjen e çmimit sipas kriterit të përcaktuar në nenin 7 të kësaj rregulloreje.

Çdo klient mund të shpallet vetëm një herë fitues gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj loje promovionale. Klientët që kanë qenë pjesë e shorteut paraardhes do të jenë automatikisht të skualifikuar për të qenë pjesëmarrës në shorteun pasardhës.

Shorteu dhe shpallja e numrave fitues do të zhvillohet në praninë e një noteri, një përfaqësuesi të AMLF-së, përfaqësuesve të Degës Rajonale të Njesisë së Tatimpaguesve të Medhenj Tiranë të cilët do të njoftohen nga Banka Credins Sh.A sipas kërkesave në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, pika 5, e 70, pika 5, të ligjit nr.155/2015, si dhe në zbatim të VKM 196 datë 15/03/2017 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë si edhe në prani të Komisionit të Lojës së Fatit Promovionale të ngritur me këtë rast nga ana e Banka Credins Sh.A.

Hedhja e secilit shorte dhe shpallja e klientëve fitues do të bëhet pranë zyrave qendrore të Banka Credins me vendndodhje në Rruga Vaso Pasha, nr.8, Tiranë, Shqipëri, ditën përcaktuar në nenin 5 që i korrespondon secilës periudhë të shorteut. Ora e shorteut do të jetë 12:00 dhe do të publikohet në faqen zyrtare në internet www.bankacredins.com. Identifikimi i fituesve dhe dhënia e çmimeve do të bëhet po në adresën e sipërcituar pas ezaurimit të procedurës së përcaktuar në nenin 7 të kësaj Rregullore.

Numri i klienteve që do të marrin pjesë në këtë promovion, parashikohet të jetë rreth 10,000 mijë.

Neni 6

ÇMIMET

Credins do të shpallë fitues 5 klientë në secilën nga datat e hedhjes së shorteut sipas përcaktimeve në nenin 5.

Çmimi që do të jepet nga Credins për secilin prej fituesve të Lojës Promovionale përfshin

- 1 kartë bankare të parapaguar të mbushur me vlerën 5,000 lekë ose ekuivalenti në Euro.

Fituesit e shorteut të parë nuk do të mund të përzgjidhen sërish në shorteun pasardhës. Pra, fituesi nuk mund të fitojë këtë çmim më shumë se një herë.

Vlera e dhuratës që do të jepet në dymbëdhjetë shortetë (5 karta të parapaguar për çdo shorte), do të jetë 352,942 lekë. Banka paguan shumën neto 5000 lek duke përllogaritur paraprakisht detyrimin 15% të tatimit mbi të ardhurat që do të thotë shuma totale në ngarkim të bankes për efekt të lojës promovionale është 5882.35 për fitues.

Credins mund të refuzojë dhënien e çmimit në rast se konstaton se nuk janë respektuar kushtet e kësaj Rregulloreje, apo në rast se fituesit/t rezultojnë të tillë si rezultat i ndonjë parregullsie që do të verifikohet gjithashtu përzgjedhja e fituesit tjetër do të bëhet shorteun e rradhës pa ndryshuar numrin e fitueseve që është deklaruar në rregullore.

Neni 7

NJOFTIMI I FITUESVE

7.1 Fituesit do të njoftohen nga ana e Banka Credins Sh.A mbi fitimin e çmimeve sipas mënyrës së detajuar te përcaktuar si vijon:

Fituesit do të njoftohen menjëherë pas hedhjes së shortit përmes një SMS-je nga Credins dhe do t'ju kërkohet të paraqiten në bankë brenda 30 ditëve nga momenti i njoftimit. Fituesit në momentin e paraqitjes në bankë duhet të jenë të pajisur me mjet identifikimi kartë identiteti/ ose pasaport.

Nëse fituesit nuk arrijnë t'i paraqiten brenda afatit të lartpërmendur, apo për çfarëdo lloj arsye tjetër nuk mund ta pranojnë çmimin, fituesit e humbasin të drejtën e përfitimit të çmimit të fituar. Çmimi është i patransferueshem dhe i pashkëmbyeshëm pavarësisht çdo rrethane apo shtate. Të gjitha çmimet do të akordohen gjatë ceremonisë së dhënies të çmimeve që do të organizohet pranë zyrave qendrore të Credins për qytetin e Tiranës dhe/ose në degën e bankës në qytetin përkatës ku çmimi është fituar.

Neni 8

TE DHENAT E PJESEMARRESVE

8.1 Çdo pjesëmarrës në këtë Lojë Fati Promocionale pranon shprehimisht se Credins mund të përpunojë të dhenat e tyre personale sipas Nenit 7 pika 1 paragrafi a) i kësaj Rregulloreje për qëllime të kësaj Lojë Fati Promocionale dhe për çdo qëllim tjetër të ligjshëm të Banka Credins Sh.A sipas ligjit "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Të gjitha të dhenat e mësipërme lidhur me fituesit dhe mënyrën e organizimit të Lojës se Fatit Promocionale do të mbahen për një periudhë jo më pak se 6 vjet.

Neni 9

TAKSA DHE TATIMET

9.1 Të gjitha detyrimet mbi Taksën e Vlerës së Shtuar që lidhen drejtpërdrejt me çmimin do të mbulohen nga Credins. Fituesi nuk do të jetë subjekt detyrimesh, tarifash apo garancish që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me çmimin përveç atyre të cilat mund të kërkohen detyrimisht për fituesin nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 10

PUBLICITETI

Komunikimi i Lojës Promocionale do të bëhet nëpërmjet një njoftimeve në televiziv; në radio, reklamimit në gazeta, reklamimit me flyer dhe postera në deget e bankes, reklamime në faqe interneti. Gjithashtu për këtë qëllim do të ketë deklarata për shtyp dhe artikuj të ngjashëm në faqen zyrtare të internetit të Banka Credins www.bankacredins.com dhe në faqen zyrtare në:

- Facebook: <https://www.facebook.com/credinsbank>.
- Instagram: <https://www.instagram.com/credinsbank>.
- LinkedIn: <https://www.linkedin.com/company/credins-bank>
- Youtube: <https://www.youtube.com/user/credinsbank/feed>.

Neni 11

FORCA MADHORE

11.1 Loja Promocionale mund të ndërpritet vetëm në rastin e rrethanave për të cilat Credins nuk është përgjegjëse, dmth., që nuk mund parandalohen, riparohen apo shmangen dhe në rast të ndonjë urdherimi sipas ligjeve në fuqi nga autoritetet shtetërore. Njoftimi për ndërprerjen e lojës nga rrethanat e lartpërmendura dhe çdo njoftim tjetër i rëndësishëm në lidhje me Lojen e Fatit Promocionale, do të publikohet në faqen zyrtare në internet www.bankacredins.com

Neni 12

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

12.1 Me kryerjen e plotesimit te formularit të përditesimit të të dhenave, klientet kanë dhënë miratimin e tyre për përfshirjen në këtë Lojë Promocionale duke pranuar automatikisht rregullat dhe mekanizmin e Lojës Promocionale. Ne rast të kërkesave të klientëve për të mos u përfshirë në këtë Lojë Promocionale, Banka Credins Sh.A nuk do t'i përfshijë ata në shortin që do të hidhet për shpalljen e fituesve. Në rast mosmarreveshjes, organi kompetent për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit të Tiranës.

Neni 13

TE NDRYSHME

13.1 Për cdo shorte që do të hidhet do të mbahet procesverbal në përfundim të tij gjithashtu cdo procesverbalit do ti bashkangjiten dhe 5 ID të fituesve. Në total do të jenë 12 procesverbale dhe 60 ID.

Rregullorja e Lojes Promocionale do te publikohet edhe në faqen në internet të Credins, www.bankacredins.com.

Informacioni mbi Lojen Promocionale mund të merret gjithashtu prej Shërbimit për Kujdesin e Klientit duke telefonuar në numrin +355 4 53 53 000.

Tirane, me 20.08.2018

Për Banka Credins Sh.A.

Monika MILO

Zv. Drejtore e Përgjithshme